



7040 /45-12  
Vendim  
01/11/2017

Në bazë të dispozitave të nenit 22 pika a e Statutit të Kolegjit UBT, nenit 3 të Rregullores për regjistrim të studentëve si dhe në bazë të nevojave të UBT-ës, për regjistrimin e studentëve për vitin e ri akademik 2017/2018, Rektori i UBT-së miratoi këtë:

### V E N D I M

- I. Shpallet konkursi i tretë i rregullt publik për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj, për vitin e ri akademik 2017/2018, në Programet e studimit Farmaci dhe Stomatologji të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK) dhe licencuara nga MASHT.
- II. Shpallja e konkursit për regjistrimin e studentëve të rinj, bëhet në mjetet e përditshme të informimit publik.
- III. Të drejtën e konkurrimit dhe të regjistrimit në studimet themelore e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë të nivelit 3 sipas ISCED dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës.
- IV. Kandidatet për regjistrim i nënshtrohen provimit pranues.  
*Përzgjedhja e kandidateve realizohet sipas këtyre kriterëve:*
  - a) Deri 20% e pikëve mund të arrihet nga suksesi në shkollën e mesme dhe testi i maturës;
  - b) Deri 80% e pikëve mund të arrihet në provimin pranues në drejtimin e Farmacisë dhe të Stomatologjisë.*Në provimin pranues kandidatet do t'i nënshtrohen testimit në lëndet:*
  - a) Kimi – 20%;
  - b) Biologji – 20%;
  - c) Logjikë – 20%;
  - d) Anglisht – 10%, si dhe
  - e) Intervistë 10%.
- V. Provimi pranues mbahet me datën 03.11.2017, ora 13:15 në Zonën Ekonomike – Lipjan – Kampusi Inovacion.
- VI. Në programin Stomatologji, si dhe në programin Farmaci për vendet e lira të mbetura, studentet do të përzgjidhen sipas kriterëve të theksuara më lartë.
- VII. Të sigurohet cilësia e pranimit të studentëve nëpërmjet suksesit më të mirë, ashtu siç është përcaktuar në konkurs.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset shërbimi përkatës i UBT-ës.
- IX. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**Rektori i UBT-së**

Prof. Dr. Edmond Hajrizi

